

STUDIM HULUMTUES
DËNIMI ME VDEKJE:

Pro et contra

Ligjërues: Nezir KRAKI

1. Hyrje

*“Varja nuk është një makinë e vdekjes, por është një simbol i terrorit, mizorisë dhe shpërfilljes ndaj jetës; emërtues i përbashkët i kësaj egërsie primitive, fanatizmi mesjetar dhe totalitarizmi modern. Ajo qëndron për gjithçka që njerëzimi duhet ta refuzojë, nëse aspiron mbijetimin e krizës së tanishme”.*¹

Në këto momente, vetëm në SHBA, 3261² njerëz po presin që të ekzekutohen si pasojë e dënimit me vdekje të shqiptuar ndaj tyre.

Ky studim ka për qëllim analizimin e opinionit publik lidhur me dënimin me vdekje, duke ofruar argumente pro dhe contra çështjes në fjalë. *Së pari*, ofron një pasqyrë të dënimit, si mjet i paraparë ligjor për të ndëshkuar të gjithë ata që nuk respektojnë rendin e ligjin; dhe *së dyti*, fokusohet në praktikën gjyqësore. Përveç pikave të lartë-përmendura, ky studim ndanë të dhëna të ndryshme, duke zbuluar kështu qëndrimet mbizotëruese në botë për dënimin me vdekje, si dënim kapital.

2. Pro et contra

*“Më mungojnë yjet. E dini, nuk i kam parë për vite, e vite, e vite. Më mungon shiu. Më mungon ushqimi. Më mungojnë të gjitha këto. Por më e rëndësishmja – dhe ajo e cila do të më lëndojë më së shumti dhe të cilën do ta mbaj si mbresë më së gjati – është të trajtohem si qenie njerëzore.”*³

Pro: Filozofë të ndryshëm kanë qenë të mendimit se dënimi mund të arsyetohet në tri mënyra të ndryshme: *ndëshkimi* – që dënimi është hakmarrja e merituar ndaj kryesit të krimit për dëmin që ai ose ajo e ka shkaktuar; *drejtësia* – që ndëshkimi paraqet një

¹Peter HODGINSON dhe Andrew RUTHERFORD, *Capital Punishment Global Issues and Prospects*, Waterside Press, Volume II, 1996; Arthur KOESTLER, *Reflects on hanging*, New York, Macmillan, 1957, f. 170.

² Statistika të dënimit me vdekje <http://www.statisticbrain.com/death-penalty-statistics/>, qasur më 09 gusht 2013.

³ Intervistë në CNN me Damian Echoles, i cili është duke pritur ekzekutimin, pasi që u dënua me vdekje që nga viti 1993, <http://edition.cnn.com/2011/CRIME/01/13/mattingley.west.memphis.three/index.html>, qasur më 09 gusht 2013.

mënyrë për të respektuar të drejtat dhe detyrat e qytetarëve, duke imponuar kështu një barrë mbi atë person i cili ka për qëllim shmangiet e bindjes ndaj ligjit; dhe *frikësimi* – se dënimi është një e keqe e domosdoshme për të parandaluar të këqija të tjera në të ardhmen duke i dekurajuar kështu kriminelët potencial.⁴

Mirëpo, pavarësisht mbështetjes së dënimit me vdekje, filozofi Immanuel Kant, dallon një të metë të këtij sistemi duke u shprehur se për të dënuar dikë sa për të frikësuar të tjerët, nënkupton se ky person përdoret vetëm si mjet dhe në këtë mënyrë ndaj tij bëhet padrejtësi.⁵ Pra, nëse ne dënojmë vetëm për t'i dhënë kryesit të krimit një ndëshkim dhe kjo nuk mjafton për të frikësuar kryesit e ardhshëm të krimeve, do të thotë se ne po krijojmë padrejtësi për viktimat potenciale.

Contra: Si argumente *contra* hasim në dy vlera thelbësore të cilat janë të garantuara me Konventa Ndërkombëtare e Regjionale për të Drejtat e Njeriut⁶: e drejta për jetë dhe vlera e saj. Qëllimi i dënimit mbi të gjitha është pendesa, e jo vdekja.⁷

Shpenzimet marramendëse për ekzekutimin e dënimit me vdekje gjithashtu njihen si arsye themelore, e të cilat mbështesin argumentin *contra*. Si shembull të përshtatshëm mund të përmendim rastin e ekzekutimit të Timothy McVeigh⁸ në SHBA, për bombardimet në Oklahoma City të cilat kaluan shifrën 13 milion dollarë. Si rrjedhojë, në New-York dhe New Jersey, për po këtë arsye të lartpërmendur, dënimi me vdekje u hoq. Kjo si rezultat i shpenzimeve marramendëse prej 170 milion dollarëve në New-York

⁴ Immanuel KANT, *The Metaphysics of Morals*, trans, E. Hastie, Edinbrught, 1887; e publikuar origjinal më 1779, f.69.

⁵ Immanuel KANT, *The Metaphysical Elements of Justice*, pjesa e parë e *The Metaphysics of Morals*, përkthyer nga J. Ladd, Indianapolis, IN: Bobbs-Merrill, 1965; publikuar në origjinal më 1797, f.100-101.

⁶ Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, Protokollin nr.13, Neni 1, shih dhe ⁶ Moratoriumi lidhur me aplikimin e dënimit me vdekje, Rezoluta A/C.3/62/L.29 e OKB-së e datës 15 nëntor 2007, <http://www.un.org/apps/news/story.asp?NewsID=24679#.Ugarr9Iwqk0>, qasur më 09 gusht 2013

⁷ Louis J. POJMAN and Jeffry REIMAN, *The death Penalty For and against*, publikuar nga Rowman & Littlefield Publishers, Inc, SHBA, 1998, f. 33.

⁸ Shpenzimet e ekzekutimit të Timothy McVeigh, <http://www.guardian.co.uk/world/2001/jun/30/mcveigh.usa>, qasur më 09 gusht 2013.

për periudhën prej 9 vitesh⁹ dhe New Jersey prej 253 milion dollarë për periudhën prej 25 vjetëve¹⁰, duke mos ekzekutuar asnjë të dënuar me vdekje. Ndërkaq, sipas të dhënave të nxjerra nga Gallup, thuhet se shpenzimet mesatare për një proces gjyqësor, e që krimi i kryer dënohet me vdekje, kushton rreth 2.4 milion dollarë.¹¹

Sipas Amnesty International, kundër dënimit me vdekje renditen një numër i madh i shteteve ku deri në maj të vitit 2012, 140 shtete¹² e kanë shfuqizuar atë në ligj ose praktikë. Por mbetet ende një numër i madh shtetesh të cilat vazhdojnë të shqiptojnë të tilla dënime. Vendet me numrin më të madh të ekzekutimeve janë: Kina, Irani, Arabia Saudite, Iraku dhe SHBA-të¹³, ndërkaq në Evropë hasim vetëm Bjellorusinë¹⁴.

3. Praktika gjyqësore

“Një metaforë që mund të jetë e dobishme për të përshkruar jurisprudencën e Gjykatës Supreme për dënimin me vdekje është ngasja e një automjeti në autostradë. Kursi i autostradës është vendosur nga historia. Gjykata Supreme është vozitësi, vazhdimisht duke bërë ndryshime të vogla sipas kushteve të rrugës dhe herë pas here duke u detyruar të reagojë në një kthesë të mbrehtë.”¹⁵

Gjykata Supreme në Amerikë, për një shekull e gjysmë, ka pranuar të artikulojë rrethanat në të cilat dënimi me vdekje përputhet me Amandamentin e Tetë¹⁶. Gjuha e

⁹ Costs on Death Penalty, Death Penalty Information Center, New York <http://www.deathpenaltyinfo.org/costs-death-penalty#FromDPIC>, qasur më 09 gusht 2013.

¹⁰ Po aty.

¹¹ Statistika të dënimit me vdekje <http://www.statisticbrain.com/death-penalty-statistics/>, qasur më 9 gusht 2013

¹² Abolitionist and retentionist countries, Amnesty International, <http://www.amnesty.org/en/death-penalty/abolitionist-and-retentionist-countries>, qasur më 09 gusht 2013.

¹³ Raporti për vitin 2012 i Amnesty Internacional, f. 34-35, <http://www.amnesty.org/en/library/asset/ACT50/001/2013/en/bbfea0d6-39b2-4e5f-a1ad-885a8eb5c607/act500012013en.pdf>, qasur më 09 gusht 2013.

¹⁴ Po aty, f. 68,

¹⁵ Revistë për Çështje Juridike dhe Shoqërore, *E Drejta*, Nr. 1/2013, Botuar nga USAID dhe Gjykata Kushtetuese e Kosovës; shkruar nga Gjyqtari John R Tunheim, *Përdorimi i precedentit për të ndërtuar ligjin*, f. 198.

¹⁶ Kushtetuta e SHBA-ve, Amandamenti i Tetë, http://www.law.cornell.edu/constitution/eighth_amendment, qasur më 09 gusht 2013.

Amandamentit nuk përcakton konkretisht se cilat ndëshkime janë të lejueshme, por në vend të kësaj, ajo e fton Gjykatën për rivlerësimin e kushtetutshmërisë së dënimeve në dritën e zhvillimeve historike.¹⁷ Me kalimin e kohës, Gjykata Supreme në periudha të caktuara e ka ri-vizituar çështjen nëse dënimi me vdekje është mizor dhe i pazakontë, duke ndërtuar një trup të precedentit që reflekton ndryshimet në normat dhe opinionin publik në të gjithë historinë e kombit amerikan.¹⁸

Rreth 18 raste të ndryshme në historinë e praktikës gjyqësore të SHBA-ve janë të njohura gjatë të cilave janë dënuar njerëz të pafajshëm për krimet që nuk i kanë kryer.¹⁹

Vendime të tilla, sipas praktikës gjyqësore janë marrë edhe në Kosovë, por kjo në një periudhë të largët, në kohën e ish Jugosllavisë, dënimi me vdekje ishte i paraparë me Kodin Penal të vitit 1976.²⁰

4. Përmbyllje

Dënimi me vdekje është dënimi më i rëndë që mund t'i shqiptohet një njeriu. Ai mundësohet nga ligjet të cilat, edhe pse paradoksalisht e ndalojnë vrasjen, në të njëjtën kohë janë makinë e kryerjeve të kësaj veprë e cila bije në kundërshtim të plotë me lirinë dhe të drejtën e jetës që njëkohësisht ofrohet nga ligji.

Cesare Beccaria thotë: *Dënimi me vdekje nuk mund të jetë i dobishëm për shkak të shembullit të barabaritetit që u jep njerëzve...duket absurde për mua që ligjet...të cilat duhet të dënojnë vrasjen, janë ata të cilët e kryejnë atë vetë.*²¹

¹⁷ Revistë për Çështje Juridike dhe Shoqërore, *E Drejta*, Nr. 1/2013, Botuar nga USAID dhe Gjykata Kushtetuese e Kosovës; shkruar nga Gjyqtari John R Tunheim, *Përdorimi i precedentit për të ndërtuar ligjin*, f. 198

¹⁸ Revistë për Çështje Juridike dhe Shoqërore, *E Drejta*, Nr. 1/2013, Botuar nga USAID dhe Gjykata Kushtetuese e Kosovës; shkruar nga Gjyqtari John R Tunheim, *Përdorimi i precedentit për të ndërtuar ligjin*, f. 199; shih gjithashtu rastet gjyqësore *Furman kundër Gjorgjisë*, *Ford kundër Wainwright*, 477 U.S. 399, 1986; *Atkins kundër Virginia* 536 U.S. 304, 2002; *Roper kundër Simmons*, 543 U.S. 551, 2005.

¹⁹ Te pafajshmit dhe dënimi me vdekje http://www.innocenceproject.org/Content/The_Innocent_and_the_Death_Penalty.php?gclid=Clu5qo2E8bgCFYy_3godBjwAnQ, qasur më 09 gusht 2013.

²⁰ Kodi Penal i ish-Jugosllavisëi vitit 1976, neni 37, http://pbosnia.kentlaw.edu/resources/legal/bosnia/criminalcode_fry.htm, qasur më 09 gusht 2013.

Andaj, duke u nisur nga ajo që u shtrua më sipër në këtë hulumtim, natyrshëm vie edhe pyetja: *Pse duhet të vrasim njerëz për të treguar se vrasja e njerëzve është e gabuar?*

Bibliografia

- 1) Peter HODGINSON dhe Andrew RUTHERFORD, *Capital Punishment Global Issues and Prospects*, Waterside Press, Volume II, 1996; Arthur KOESTLER, *Reflects on hanging*, New York, Macmillan, 1957.
- 2) Louis J. POJMAN and Jeffry REIMAN, *The death Penalty For and against*, publikuar nga Rowman & Littlefield Publishers, Inc, SHBA, 1998.
- 3) Immanuel KANT, *The Metaphysics of Morals*, trans, E. Hastie, Edinbrught, 1887; e publikuar original më 1779.
- 4) Immanuel KANT, *The Metaphysical Elements of Justice*, pjesa e parë e *The Metaphysics of Morals*, përkthyer nga J. Ladd, Indianapolis, IN: Bobbs-Merrill, 1965; publikuar në original më 1797.
- 5) Revistë për Çështje Juridike dhe Shoqërore, *E Drejta*, Nr. 1/2013, Botuar nga USAID dhe Gjkata Kushtetuese e Kosovës; shkruar nga Gjqatari John R Tunheim, *Përdorimi i precedentit për të ndërtuar ligjin*.
- 6) Cesare BECCARIA, *Of Crimes and Punishments*, përkthyer nga H. Paulucci, Indianapolis: Bobbs-Merrill, 1963, publikuar original më 1764.
- 7) "Statistika të dënimit me vdekje" <http://www.statisticbrain.com/death-penalty-statistics/>, qasur më 09 gusht 2013.
- 8) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, Protokoll nr.13.
- 9) Moratoriumi lidhur me aplikimin e dënimit me vdekje, Kombet e Bashkuara Rezoluta A/C.3/62/L.29, <http://www.un.org/apps/news/story.asp?NewsID=24679#.Ugarr9Iwqk0>, qasur më 09 gusht 2013.
- 10) "Shpenzimet e ekzekutimit të Timothy McVeigh" <http://www.guardian.co.uk/world/2001/jun/30/mcveigh.usa>, qasur më 09 gusht 2013.
- 11) "Costs on Death Penalty, Death Penalty Information Center", New York <http://www.deathpenaltyinfo.org/costs-death-penalty#FromDPIC>, qasur më 09 gusht 2013.
- 12) "Abolitionist and retentionist countries", Amnesty International, <http://www.amnesty.org/en/death-penalty/abolitionist-and-retentionist-countries>, qasur më 09 gusht 2013.
- 13) "Raporti për vitin 2012" Amnesty Internacional, <http://www.amnesty.org/en/library/asset/ACT50/001/2013/en/bbfea0d6-39b2-4e5f-a1ad-885a8eb5c607/act500012013en.pdf>, qasur më 09 gusht 2013.
- 14) Te pafajshmit dhe dënimi me vdekje http://www.innocenceproject.org/Content/The_Innocent_and_the_Death_Penalty.php?gclid=Clu5qo2E8bgCFYy_3godBjwAnQ, qasur më 09 gusht 2013.
- 15) Kodi Penal i ish-Jugosllavisë i vitit 1976, neni 37, http://pbosnia.kentlaw.edu/resources/legal/bosnia/criminalcode_fry.htm, qasur më 09 gusht 2013.

²¹Louis J. POJMAN and Jeffry REIMAN, *The death Penalty For and against*, publikuar nga Rowman & Littlefield Publishers, Inc, SHBA, 1998, f. 29; shih dhe Cesare BECCARIA, *Of Crimes and Punishments*, përkthyer nga H. Paulucci, Indianapolis: Bobbs-Merrill, 1963, publikuar original më 1764.